



Empowered lives.
Resilient nations.

Pulsi Publik -VIII-

Nëntor 2014

Përgatitur nga UNDP Kosovë¹ - ekipi i Projektit Pulsi Publik:

Atdhe Hetemi,
Menaxher i Projektit Pulsi Publik

Iris Duri,
Statisticiente – Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim

Erëblina Elezaj,
Analiste hulumtuese – Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim

Aida Emini dhe Christine Vlastic,
Praktikante – Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim

Kontrolli i cilësisë,
Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim

Prishtinë
Nëntor 2014

¹ Për UNDP, çdo referencë e Kosovës në këtë dokument bëhet në kontekst të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999).

Dokumenti Pulsit Publik ofron një pasqyrë të saktë të treguesve kyçë dhe rezultateve të Anketës së Pulsit Publik. Ky dokument përmbledhës përfshin periudhën nga prilli deri nëntor të vitit 2014 dhe ndjek traditën e raporteve të mëparshme duke shqyrtuar situatën e ndrysheshme në Kosovë në fushën politike, ekonomike, të sigurisë dhe zhvillimit. Të dhënat shtesë të siguruar përmes këtij sondazhi do të jenë në dispozicion përmes Analizës së Pulsit Publik dhe Dokumentit të Veprimit.

Treguesit kryesorë të Pulsit Publik

Kënaqshmëria me performancën e Institucioneve Publike

Rezultatet e Anketës Pulsit Publik tregojnë rënie të konsiderueshme të kënaqshmërisë së njerëzve me punën e institucioneve kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës. Vetëm rreth 25% të kosovarëve kanë deklaruar të jenë të kënaqur me performancën e institucioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore së bashku.

Në periudhën ndërmjet prillit dhe nëntorit 2014, niveli i kënaqshmërisë me punën e Institucioneve Qendrore të Kosovës është ulur për 25 pikë përqindjeje, duke arritur nivelin e tyre më të ulët që nga marsi 2007. Më pak se 20% e kosovarëve janë të kënaqur me punën e Institucioneve Qendrore të Kosovës. Përveç kësaj, vetëm 34% të kosovarëve janë të kënaqur me punën e Kryeministrit, në krahasim me 48.5% në prill të vitit 2014.

Institucionet legjislative, siç janë Parlamenti dhe Kryetari i Kuvendit, kanë pësuar rënie të nivelit të kënaqshmërisë prej rreth 31 dhe 35 pikë përqindjeje. Këto institucione gjithashtu kanë arritur nivelet më të ulëta të tyre të kënaqshmërisë që nga marsi i vitit 2007. Vetëm 16% e kosovarëve janë të kënaqur me punën e Kuvendit, ndërsa 23% janë të kënaqur me punën e Kryetarit të Kuvendit. Ndonëse Presidentja gëzon nivelin më të lartë të kënaqshmërisë nga qytetarët, ky nivel i kënaqshmërisë poashtu ka pësuar rënie. Rreth 41% e kosovarëve janë të kënaqur me punën e Presidentes (në krahasim me 48.8% në prill të vitit 2014).

Gjyqësori poashtu nuk bën përjashtim në rënien e nivelit të kënaqshmërisë me punën e tij. Përqindja e kosovarëve që janë të kënaqur me punën e gjykatave të Kosovës ka rënë nga 38% në 23% në mes të prillit dhe nëntorit 2014. Një rënie prej rreth 17 pikë përqindjeje ka shënuar nivelin e kënaqshmërisë me punën e Prokurorisë, duke e sjellë atë në pikën më të ulët të të gjitha kohërave prej 21% të kosovarëve (në krahasim me 38% në prill të vitit 2014) (shih Tabelën 1).


Tabela 1: Niveli i kënaqshmërisë me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës

		Mars-07	Maj-08	Qer-09	Prill-10	Nën-10	Qer-11	Tet-12	Prill-13	Prill-14	Nën-14	Trendi
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Institucionet qendrore	30.5%	46.9%	53.1%	29.2%	25.1%	32.6%	27.2%	27.0%	44.2%	19.3%	
	Kryeministri	54.0%	72.0%	53.8%	36.4%	30.7%	37.6%	27.3%	30.4%	48.5%	34.1%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	31.0%	51.4%	53.2%	34.1%	32.1%	41.0%	32.1%	32.3%	46.5%	16.1%	
	Kryetari i Kuvendit	35.4%	56.5%	51.6%	36.0%	33.3%	60.9%	44.7%	45.8%	57.8%	23.3%	
	Presidenti	52.0%	74.0%	61.7%	54.9%	30.8%	54.1%	47.1%	45.1%	48.8%	40.7%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	20.0%	21.0%	32.7%	27.2%	18.5%	26.9%	24.3%	16.7%	37.5%	22.8%	
	Zyra e prokurorit	22.7%	22.7%	31.7%	26.9%	15.1%	20.0%	15.0%	17.7%	38.1%	21.0%	

Perceptimet mbi drejtimin politik dhe ekonomik


Pakënaqësia e kosovarëve lidhur me punën e institucioneve kryesore, gjithashtu pasqyrohet në përgjigjet e tyre në pyetjet që kanë të bëjnë me kënaqshmërinë e tyre me drejtimin politik në të cilin po shkon Kosova. Vetëm 5% të kosovarëve duket të jenë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin e tanishëm politik të Kosovës (në krahasim me 21% në prill 2014). Shumica e kosovarëve duket se janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me drejtimin e tanishëm politik të Kosovës (72%, krahasuar me 42.5% në prill të vitit 2014) (*shih Figurën 1*).

Figura 1: Kënaqshmëria me drejtimin politik të Kosovës




Rreth 39% të kosovarëve janë përgjigjur pozitivisht kur janë pyetur nëse janë të gatshëm të protestojnë për arsye politike. Përqindje më e lartë e serbëve (49.5%), në krahasim me respondentët shqiptarë (39.1%) kanë pohuar se do të ishin të gatshëm t’ju bashkohen protestave politike. Vetëm 18.5% të pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike kanë deklaruar se do të protestonin kundër situatës aktuale politike (*shih Figurën 2*).

Figura 2: Përqindja e respondentëve që janë të gatshëm të protestojnë kundër gjendjes aktuale politike



Rezultatet e sondazhit të opinionit publik të nëntorit 2014 tregojnë se Indeksi i Demokratizimit (ID) (1.09) ka rënë për 0.12 pikë që nga prilli 2014. Duke pasur parasysh që ID mund të ketë vlerë nga 0 deri 3, indeksi aktual tregon se shumica e njerëzve nuk kanë opinion pozitiv në lidhje me proceset demokratike në Kosovë. Ngjashëm me indeksin e demokratizimit, Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) – i cili gjithashtu mund të ketë vlerë nga 0 deri 3 – dhe që aktualisht është vlerësuar të jetë 0.94, tregon se kosovarët nuk kanë pikëpamje optimiste për ekonominë dhe drejtimin e saj të tanishëm (shih Figurën 3).

Figura 3: Indekset e demokratizimit dhe besueshmërisë ekonomike²



Për të përcaktuar se cilët faktorë kanë nxitur rënien e vlerës së indeksit, është kryer një analizë e trendit që krahason vlerat e faktorëve që shfrytëzohen për ndërtimin e ID-së. Rezultatet tregojnë se ka pasur rënie të vlerave të të gjithë komponentëve që kur përmbledhen e formojnë këtë indeks. Në krahasim me atë të prillit 2014, përqindja e kosovarëve që besojnë se Kushtetuta dhe Ligjet në fuqi janë demokratike dhe respektojnë të drejtat e njeriut, ka pësuar rënie më të madhe, nga 35% në 24% në nëntor të vitit 2014. Komponentët e tjerë që treguan rënie të konsiderueshme janë pavarësia e sistemit gjyqësor, si dhe besimi që shoqëria civile në Kosovë shërben si monitoruese e vërtetë e zhvillimeve demokratike në Kosovë. Në prill të vitit 2014, rreth 25% të qytetarëve besonin në pavarësinë e sistemit gjyqësor të Kosovës, ndërsa ky sondazh tregon se vetëm 16% e kosovarëve kanë besim në pavarësinë e tij. Ngjashëm, në prill të vitit 2014, rreth 29% të qytetarëve besonin që shoqëria civile shërben si monitoruese e vërtetë e zhvillimeve demokratike në Kosovë, ndërsa

² Shih faqen e fundit të dokumentit për më shumë informata rreth llogaritjes së indekseve

sondazhi i fundit tregon se vetëm 21% të kosovarëve ndajnë këtë mendim. Tregues të tjerë të demokratizimit për të cilët ka mbledhur të dhëna anketa e Pulsit Publik gjithashtu tregojnë rënie në besimin e qytetarëve me lirinë e shprehjes së mediave (40%, krahasuar me 45% në prill 2014), si dhe në aftësinë e parlamentit për të monitoruar performancën e institucioneve qendrore (21.5 % krahasuar me 28.5% në prill 2014), etj. (Sih Tabelën 2).

Tabela 2: Analizë e trendeve të komponentëve të Indeksit të Demokratizimit – Përqindja e përgjigjeve pozitive në pyetjet e Indeksit të Demokratizimit (përqindja e respondentëve që “pajtohen plotësisht” apo “kryesisht pajtohen”)

Plotësisht po dhe Kryesisht po	Nën-10	Qer-11	Nën-11	Prill-12	Tetor-12	Prill-13	Prill-14	Nën-14	Trendi
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	31.0%	29.3%	23.1%	17.0%	16.2%	15.0%	36.4%	34.0%	
A e monitoron Kuvendi performancën e Institucioneve Qendrore?	20.7%	20.7%	19.4%	16.7%	17.7%	17.5%	28.5%	21.5%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet që merret?	13.2%	15.6%	11.3%	12.3%	15.7%	10.6%	24.8%	16.0%	
A gëzojnë mediat në Kosovë liri të shprehjes?	29.2%	33.9%	33.3%	34.7%	37.3%	24.6%	45.4%	39.6%	
A shërben shoqëria civile në Kosovë si monitoruese e vërtetë e zhvillimeve demokratike në Kosovë?	22.6%	18.9%	20.3%	19.0%	24.4%	18.3%	28.8%	21.3%	
A është duke punuar qeveria lokale e juaj (komuna) në përputhje me prioritetet e qytetarëve të Kosovës?	27.7%	26.7%	29.0%	25.7%	27.3%	26.1%	32.6%	29.5%	
A janë duke punuar Institucionet Qendrore sipas prioriteteve të qytetarëve?	14.3%	16.1%	14.6%	12.9%	15.3%	16.4%	26.4%	18.2%	
A janë kushtetuta dhe ligjet e Kosovës në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	32.6%	27.9%	26.5%	25.9%	26.0%	33.0%	35.3%	24.2%	
Pavarësisht politikës ditore dhe duke shikuar përpara drejt të ardhmes, a pajtoheni se proceset demokratike në Kosovë janë institucionalizuar dhe janë duke shkuar në drejtimin e duhur?	25.6%	24.5%	17.9%	18.1%	18.6%	23.0%	33.0%	33.0%	


Ngjashëm me treguesit ID, përgjigjet aktuale pozitive të komponentëve IBE-së gjithashtu janë krahasuar me ato të prillit 2014. Këtu gjithashtu është vërejtur që shumica e komponentëve kishin ndikim në uljen e përgjithshme të IBE-së. Rezultatet zbulojnë që vetëm përqindja e kosovarëve që besojnë se të ardhurat totale të familjeve të tyre do të rriten në periudhën afatshkurtër (gjashtë muaj) është rritur nga 15% në prill në 20% në nëntor të vitit 2014. Vetëm 8% dhe 9% të kosovarëve kanë mendim të favorshëm për gjendjen aktuale të punësimit dhe biznesit. Përqindja e kosovarëve me pritje pozitive lidhur me gjendjen e punësimit në të ardhmen e afërt (gjashtë muaj), pësoi rënie të madhe, nga 13.7% në prill në 7.3% në nëntor 2014 (shih Tabelën 3).

Tabela 3: Analiza e trendit në përqindje të përgjigjeve pozitive në pyetjet e komponenteve të IBE-së (përqindja e respondentëve që i konsiderojnë ato "të favorshme")

Të favorshme	Nën-11	Qer-11	Nën-11	Prill-12	Tetor-12	Prill-13	Prill-14	Nën-14	Trendi
Çfarë janë pritjet uaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj pas gjashtë muajsh?	16.8%	12.1%	8.5%	9.9%	9.6%	7.6%	17.0%	19.7%	
Çfarë është vlerësimi juaj mbi kushtet aktuale të biznesit?	10.7%	9.7%	6.0%	7.9%	6.7%	4.8%	11.6%	8.8%	
Çfarë është mendimi juaj mbi gjendjen aktuale të punësimit?	4.0%	3.3%	3.8%	3.4%	3.8%	5.1%	9.2%	7.7%	
Çfarë janë pritjet tuaja lidhur me gjendjen e punësimit pas gjashtë muajsh?	14.3%	12.4%	8.0%	7.6%	7.4%	6.4%	13.7%	7.3%	

Pakënaqësia publike me drejtimin ekonomik të Kosovës është edhe më e lartë se ajo me drejtimin e saj politik: rreth 79% të të gjithë respondentëve janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual ekonomik të Kosovës, ndërsa vetëm rreth 5% janë të kënaqur me të. Të dhënat e mbledhura nga sondazhi i opinionit tregojnë se pakënaqësia e komuniteteve të tjera (81%) dhe shqiptarëve (79%) është më e lartë se ajo e serbëve (73%) (shih Figurën 4).


Figura 4: Niveli i kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik të Kosovës



Perceptimet e problemeve kryesore

Sipas respondentëve, problemi më i madh me të cilin përballet Kosova është papunësia, vijuar nga varfëria (24%) dhe korrupsioni (5%). Pesëdhjetë e pesë për qind të kosovarëve konsiderojnë se papunësia është problemi kryesor në Kosovë. Përveç kësaj, respondentët gjithashtu nuk janë të bindur se ka punësim të bazuar në merita në sektorin publik. Rezultatet e kësaj ankete tregojnë që 79% të kosovarëve besojnë se lidhjet familjare, ryshfeti, lidhjet partiake dhe bazat e tjera jomeritore janë faktorët më të rëndësishëm për tu punësuar në sektorin publik në Kosovë. Vetëm 13% të respondentëve besojnë se arsimi, përvoja profesionale dhe aftësimi profesional në kombinim janë të rëndësishme për të gjetur punë në sektorin publik (shih Figurën 5).

Figura 5: Perceptimet mbi meritokracinë në punësim në sektorin publik



Korrupsioni vazhdon të jetë një nga problemet më të rëndësishme për kosovarët. Një numër i madh i kosovarëve mendojnë që korrupsioni i shkallës së lartë është i pranishëm në shumë institucione dhe kjo përqindje është rritur në krahasim me rezultatet e prillit 2014. Institucionet që perceptohen se kanë vlerë të lartë të korrupsionit përfshijnë: ofruesit e kujdesit shëndetësor 56% (në krahasim me 40% në prill të vitit 2014), gjykatat 42% (në krahasim me 32% në prill 2014), KEK, 39% (krahasuar me 24% në prill të vitit 2014), administrata/institucionet qendrore 37.5% (krahasuar me 24% në prill 2014), Agjencia Kosovare e Privatizimit 35% (në krahasim me 25% në prill 2014) dhe Doganat 33% (në krahasim me 24% në prill 2014) (shih Tabelën 4).


Tabela 4: Perceptimet mbi praninë e korrupsionit në shkallë të lartë në institucionet në Kosovë

	Nëntor-10	Qershor-11	Nëntor-11	Prill-12	Shtator-12	Prill-13	Prill-14	Nëntor-14	Trendi
Shëndetësia (spitalet)	47.9%	40.7%	49.8%	43.3%	51.6%	50.4%	40.4%	56.2%	
Gjykatat	49.7%	41.6%	55.6%	44.5%	47.5%	56.4%	32.2%	42.1%	
KEK	52.4%	47.9%	61.2%	47.8%	53.8%	48.8%	24.4%	39.1%	
Administrata/institucionet qendrore	47.5%	41.4%	43.3%	39.5%	35.7%	46.1%	24.0%	37.5%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	52.0%	40.5%	51.9%	49.4%	46.4%	48.7%	24.6%	34.8%	
Doganat	45.1%	42.3%	53.7%	43.2%	49.9%	58.9%	22.5%	33.4%	
Komunat (qeveria lokale)	32.9%	30.4%	31.9%	30.1%	32.2%	38.9%	20.6%	33.2%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)		24.9%	36.5%	38.1%	33.6%	42.5%	16.5%	28.0%	
Arsimi (Shkollat, Universitetet)	14.4%	13.1%	17.3%	26.2%	23.5%	31.6%	13.0%	24.3%	
PTK	34.0%	32.4%	46.6%	41.8%	45.1%	41.4%	15.4%	21.3%	
Bankat	14.4%	14.9%	22.0%	20.5%	22.8%	37.5%	12.0%	17.0%	
Policia e EULEX (CIVPOL)	22.9%	26.2%	27.1%	28.3%	28.7%	38.3%	11.1%	16.5%	
Organizatat Ndërkombëtare	14.7%	12.3%	20.3%	19.3%	20.8%	24.8%	10.8%	16.2%	
Policia e Kosovës (PK)	15.2%	15.5%	19.5%	19.4%	28.0%	30.3%	11.5%	16.1%	

Perceptimet mbi diskriminimin

Respondentët janë pyetur poashtu për mendimin e tyre në lidhje me atë se cilat grupe janë më të ekspozuara ndaj diskriminimit në Kosovë. Shumica e respondentëve kanë identifikuar grupet në vijim: të moshuarit (23.5%), gratë/vajzat dhe personat me aftësi të kufizuara – duke përfshirë ata që kanë dëmtime afatgjate fizike, mendore, intelektuale apo shqisore (secila nga 19%) (shih Figurën 6).

Figura 6: Grupet që perceptohen si më të ekspozuarat ndaj diskriminimit në Kosovë






USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Empowered lives.
Resilient nations.

Anketa e opinionit gjithashtu i ka pyetur respondentët nëse janë ndier të diskriminuar në ndonjë moment në të kaluarën e afërt dhe, nëse po, në çfarë baze. Rezultatet e anketës tregojnë se kosovarët ndihen të diskriminuar kryesisht për këto arsye: opinionet politike apo të tjera (31%), gjinia (29%) dhe mosha (24%). Numër më i vogël i respondentëve u deklaruan se përkatësia etnike (12%), aftësia e kufizuar (7%) si dhe besimet fetare (3%) janë bazat më të shpeshta për diskriminim (*shih Figurën 7*).


Figura 7: Bazat për diskriminim kundër respondentëve që janë ndier të diskriminuar në të kaluarën e afërme



Ngërçi politik dhe sjellja e votuesve


Gati gjashtë muaj pas zgjedhjeve, po rritet presioni për t'i dhënë fund ngërçit politik të Kosovës. Kur janë pyetur nëse koalicioni i ri trepalësh – që synon të formojë Institucionet e reja Qendrore – do të ishte i mirë apo i keq për Kosovën, shumica e respondentëve (37.5%) refuzuan të përgjigjen ose deklaruan se nuk e dinë. Në anën tjetër, 25% e kosovarëve besojnë se nëse koalicioni arrin në pushtet, kjo do të jetë e dobishme për Kosovën, ndërsa 23% besojnë të kundërtën. Pesëmbëdhjetë për qind të respondentëve konsiderojnë se është shumë herët të kenë opinion mbi koalicionin (*shih Figurën 8*).

Figura 8: Perceptimet mbi planet e koalicionit trepalësh për të formuar Institucionet e reja Qendrore të Kosovës




Mbi 53% e kosovarëve nuk e dinin apo refuzuan të përgjigjen në pyetjen nëse Institucionet e formuara nga ky koalicion trepalësh do të ishin në gjendje të shërbenin mandatin e plotë deri në zgjedhjet e ardhshme. Njëzetepesë për qind të respondentëve deklaruan se një ekzekutiv i tillë me gjasë apo me shumë gjasë do ta shërbente mandatin e plotë, ndërsa 21% e besojnë të kundërtën (*shih Figurën 9*).

Figura 9: Perceptimet lidhur me mundësinë që Institucionet e reja Qendrore të formuara nga koalicioni trepalësh do të shërbejnë tërë mandatin deri në zgjedhjet e ardhshme të rregullta




Meqë zgjedhjet gjithashtu konsiderohen të jenë zgjidhje e mundshme për krizën aktuale politike në Kosovë, qytetarët janë pyetur edhe për qëndrimet kundrejt votimit. Anketa e fundit tregon se qëndrimet e kosovarëve ndaj votimit janë mjaft pesimiste. Një numër mjaft i lartë i respondentëve beson se vota e tyre nuk do të mund ta ndryshojë gjendjen në Kosovë (45%, në krahasim me 37% në prill 2014), apo nuk e dinë nëse vota e tyre do të mund ta ndryshojë atë (22%, në krahasim me 16% në prill 2014). Vetëm 31% të votuesve potencial (në krahasim me 47% në prill të vitit 2014) besojnë që vota e tyre do të mund ta ndryshojë gjendjen në Kosovë (*shih Figurën 10*).

Figura 10: Perceptimet mbi fuqinë e votës si mjet për ndryshimin e gjendjes aktuale politike në Kosovë



Pulsi Publik gjithashtu i ka pyetur kosovarët lidhur me preferencat e tyre të votimit në rast se mbahen zgjedhjet, dhe gjetjet tregojnë se vetëm 29% të tyre (në krahasim me 54% në prill 2014) kanë deklaruar se do të votojnë për një parti të caktuar politike ose koalicion nëse mbahen zgjedhjet, ndërsa 14% kanë deklaruar se nuk kanë preferenca politike. Ajo që shquhet më shumë në këtë grup pyetjesh është përqindja e lartë e atyre që deklaruan se nuk do të votojnë (17%, në krahasim me 13% në prill të vitit 2014), dhe e atyre që nuk janë përgjigjur fare në pyetje (40%, në krahasim me 21% në prill të vitit 2014) (shih Figurën 11).


Figure 11: Preferencat e votimit



Perceptimet mbi radikalizimin fetar


Tridhjetë e shtatë për qind të kosovarëve mendojnë se myslimanët në Kosovë janë ndikuar më shumë ose deri në një masë nga format ekstreme radikale të Islamit gjatë dy viteve të fundit. Nga ana tjetër, 33% e respondentëve kanë deklaruar se nuk e dinë, ose thjeshtë kanë refuzuar të japin përgjigje në këtë pyetje. Ndërsa vetëm 16% e respondentëve kanë deklaruar se këto nivele të ndikimit kanë mbetur të njëjta, përderisa 14% mendojnë se gjatë dy viteve të fundit myslimanët në Kosovë janë bërë shumë më pak apo disi më pak të ndikuar nga format ekstreme apo radikale të Islamit (shih Figurën 12).

Figura 12: Përqindja e respondentëve që mendojnë që Myslimanët në Kosovë janë ndikuar Më shumë dhe Shumë më shumë nga format ekstreme apo radikale të islamit, sipas grupmoshës




Nëse analizohen në baza etnike, rezultatet tregojnë se një përqindje e lartë e serbëve (78%), besojnë se kosovarët kanë gjasë të konsiderueshme apo të lartë të ndikohen nga grupet radikale fetare në krahasim me shqiptarët (40%) dhe grupet tjera etnike të Kosovës (32.5%). Duhet theksuar se gjetjet tregojnë se 52% e atyre që konsiderojnë se kosovarët me gjasë po ndikohen nga grupet radikale fetare i përkasin grupmoshës 18-24 vjeçe (shih Figurën 13).

Figura 13: Perceptimet për ndikimin nga grupet radikale fetare, sipas përkatësisë etnike, grupmoshës dhe gjinisë



Kosovarët gjithashtu janë pyetur për opinionin e tyre lidhur me mundësinë që Kosova të bëhet cak i sulmeve terroriste. Gjetjet tregojnë se një pjesë e madhe e kosovarëve (42%), konsiderojnë se ka pak apo shumë pak gjasa që Kosova të bëhet objekt i sulmeve terroriste. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e tyre (32.5%), e konsiderojnë si të mundshme që Kosova të bëhet cak i sulmeve terroriste. Zbërthimi i rezultateve sipas gjinisë tregon se përqindja e meshkujve (37%), që mendon se Kosova ka gjasa të bëhet cak i sulmeve terroriste është më e lartë në krahasim me atë të femrave (29%). Të dhënat e zbërthyera sipas etnisë tregojnë se shumica e atyre që mendojnë se Kosova ka gjasa të bëhet cak i sulmeve terroriste janë serbë (70.5%), pastaj shqiptarët (31%) dhe komunitetet e tjera (22.5%) (shih Figurën 14).

Figura 14: Përqindja e respondentëve që besojnë që Kosova ka gjasë apo me shumë gjasë do të bëhet cak i sulmeve terroriste, sipas gjinisë, grupmoshës dhe përkatësisë etnike






USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Empowered lives.
Resilient nations.


Për të kuptuar se çfarë ka ndikuar në krijimin e perceptimeve të kosovarëve lidhur me ekstremizmin fetar, respondentët janë pyetur se ku janë informuar për këtë çështje. Gjetjet tregojnë se një shumicë pothuajse absolute e respondentëve (93.5%) i kanë krijuar mendimet e tyre përmes: mediave elektronike dhe të shtypura (52%), bisedave me miqtë dhe të afërmit (34%) dhe portaleve në internet, si dhe faqet e mediave sociale si Facebook dhe Twitter (9.5%). Megjithatë, 4% të respondentëve kanë deklaruar se i kanë formuar mendimet e tyre në bazë të përvojave personale (kanë parë ose dëgjuar njerëz që promovojnë ekstremizmin, dhe nga mësimet radikale). Ndarja e rezultateve sipas grupmoshës tregon që një pjesë krahasimisht më e lartë e respondentëve që i përkasin grupmoshave 25-30 vjeç dhe 31-36 vjeç (nga 7% secila), e kanë formuar opinionin e tyre mbi ekstremizmin fetar bazuar në përvoja personale (shih Figurën 15).

Figura 15: Burimet e raportuara të informimit që kanë formësuar opinionet e kosovarëve për ekstremizmin fetar në Kosovë, sipas grupmoshës




Kur janë pyetur lidhur me operationet e fundit të policisë në Kosovë, që përfshinin arrestimin e një numri të imamëve si dhe individëve që ishin të dyshuar për përfshirje në konfliktet në Lindjen e Mesme dhe mbështetjen e organizatave terroriste, shumica e kosovarëve (88%) deklaruan se kishin dëgjuar shumë, deri diku apo pak në lidhje me këto arrestime në Kosovë. Vetëm rreth 8% të respondentëve kanë deklaruar se nuk dinë apo se nuk kanë dëgjuar për këto arrestime. Të dhënat e ndara në bazë etnike konfirmojnë se një përqindje më e madhe e serbëve (16%) dhe komuniteteve të tjera (17%) në krahasim me shqiptarët (3%), nuk kanë dëgjuar për këto arrestime (shih Figurën 16).

Figura 16: Informimi për arrestimet e fundit të imamëve në Kosovë, sipas përkatësisë etnike



Gjysma e respondentëve që kanë dëgjuar për këto arrestime kanë deklaruar se i aprovojnë apo aprovojnë fuqimisht arrestimet e këtyre grupeve të imamëve, pavarësisht se sa shumë informata kishin mbi ta. Kur analizohen në baza etnike, rezultatet tregojnë se rreth 92% të serbëve i aprovojnë ose fuqimisht aprovojnë këto arrestime, pasuar nga 49% të shqiptarëve dhe 37% të komuniteteve të tjera të Kosovës. Nga ana tjetër, 26% të respondentëve nuk i aprovojnë apo fuqimisht nuk i aprovojnë këto arrestime pavarësisht se sa shumë informata kishin mbi këtë çështje kur u zhvillua anketa. Duhet të theksohet se gati një e katërta e respondentëve nuk e dinin ose thjeshtë refuzuan që të japin mendimin e tyre lidhur me këtë pyetje (shih Figurën 17).

Figura 17: Perceptimet mbi arrestimet e kohëve të fundit të imamëve në Kosovë, sipas përkatësisë etnike



Perceptimet për sigurinë në Kosovë

Si tregues për sigurinë, respondentët janë pyetur nëse ndjehen të sigurt ose të pasigurt gjatë kohës sa janë jashtë shtëpisë. Ndonëse ekziston një trend përgjithësisht pozitiv në këtë drejtim, të dhënat e nëntorit 2014 tregojnë se: 67% të kosovarëve ndjehen të sigurt jashtë shtëpisë, ndërsa rreth 26% (në krahasim me 33% në prill 2014) përgjithësisht ndjehen të pasigurt. Kur të analizohen këto të dhëna



USAID


NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

në baza gjinore, nuk janë vërejtur dallime të konsiderueshme ndërmjet përqindjes së grave dhe burrave që ndjehen të sigurt sa janë jashtë shtëpisë (*sib Figurën 18*).



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Figura 18: Siguria jashtë shtëpisë



Metodologjia

Këto rezultate janë bazuar në mostër të anketës me 1,306 qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeçe, të të dy gjinive dhe nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar zonat rurale dhe urbane. Mostra ka përfshirë 896 shqiptarë, 210 serbë dhe 200 pakica joserbe të Kosovës (gjegjësisht turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkali dhe egjiptianë). Metoda e anketimit është përmes mostrimit të rastësishëm të probabilitetit në shumë faza. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë. Anketa është realizuar nga Index-Kosova (Prishtinë) gjatë fundit të tetorit dhe fillimit të nëntorit 2014.

Shënim për peshimin e totaleve

Anketat e realizuara për Pulsin Publik marrin mostra të tepërta të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të ndahen sipas përkatësisë etnike, megjithatë kur bëjmë përlogaritjet për totalet, peshimi bëhet sipas shifrave aktuale të popullatës.

Që nga viti 2002, përqindjet vijuese për peshimin e totaleve për nivel të Kosovës janë shfrytëzuar në anketat tona:

- Shqiptarë 88%
- Serbë 6%
- Komunitete të tjera (boshnjakë, turq, goranë, RAE) 6%.

Megjithatë, sipas regjistrimit të popullsisë dhe rezultateve zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike është si vijon:

Etnia	Popullsia	Përqindja
Shqiptarë	1,616,869	92.93



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Empowered lives.
Resilient nations.

Serbë	25,532	1.47
Turq	18,738	1.08
Boshnjakë	27,533	1.58
Romë	8,824	0.51
Ashkali	15,436	0.89
Egjiptianë	11,524	0.66
Goranë	10,265	0.59
Të tjerë	2,352	0.14
Gjithsej	1,739,825	100.00

Nëse do t'i aplikonim shifrat e mësipërme në anketat tona, peshimi do të ishte si në vijim:

- 93% shqiptarë
- 2% serbë
- 5% të tjerë.

Duke e pasur parasysh që serbët në pjesën veriore të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, së bashku me observimin e përgjithshëm që shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, ne kemi vlerësuar se duhet të shtojmë 40,000 të tjerë për serbët, që arrin totalin prej 65,532. Kjo gjithashtu rritë numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës në 1,779,825.

Kur i marrim parasysh këto ndryshime, peshimi në anketat tona do të bëhet si në vijim:

- 92% shqiptarë
- 4% serbë
- 4% të tjerë (boshnjakë, turq, goranë, RAE)

Përlllogaritja e indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në vlerësimin e respondentëve të nivelit të tyre të pajtimit apo mospajtimit lidhur me zhvillimin e proceseve të mëposhtme në Kosovë: zgjedhje të lira dhe të ndershme, monitorimi i performancës së institucioneve qendrore nga parlamenti, sistem i pavarur gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, institucione qendrore që funksionojnë në bazë të prioriteteve të qytetarëve, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut në bazë të kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, dhe nëse qeveritë lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. Indeksi është vlerë e vazhdueshme e cila mund të ndryshojë nga 3 (maksimumi), që do të thotë se të gjithë respondentët pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur, deri në 0 (minimalja), që do të thotë se respondentët nuk pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i besueshmërisë ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të respondentëve për atë se sa të favorshme ose të pafavorshme janë kushtet aktuale ekonomike në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, respondentët vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me gjendjen e përgjithshme të të ardhurave dhe punësimit të familjes së tyre për gjashtë muajt e ardhshëm dhe vlerësimi i kushteve të biznesit dhe punësimit. Vlerat mund të jenë nga 0 (minimumi) deri 3 (maksimumi) ku vlerat nga 0-1.5 tregojnë vlerësim jo të favorshëm të gjendjes ekonomike ndërsa vlerat 1.5-3 tregojnë vlerësim kryesisht të favorshëm.